



Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësive të institucioneve, pjesë të Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit gusht, 2025

Progres i qendrueshëm zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit

**1-29.08.2025:** Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka monitoruar zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit. Përgjatë muajit gusht është kryer vlerësimi dhe është përgatitur drafti i raportit të monitorimit, i cili paraqet ecurinë e zbatimit të masave të parashikuara në kuadër të periudhës së dytë të vitit të dytë (2025) të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030. Ky raport ndërtohet mbi një proces të rregullt e gjithëpërfshirës të mbledhjes, përpunimit dhe analizimit të të dhënave të siguruar nga institucionet publike zbatuese në nivel qendror e vendor, si dhe nga aktorë të tjerë institucionalë të përfshirë në zbatim. Vlerësimi i progresit kryhet në përputhje të plotë me kuadrin e matjes së performancës dhe me metodologjinë e miratuar për monitorimin e strategjisë, duke u fokusuar në analizën e treguesve të performancës, krahasimin me vlerat e synuara dhe evidentimin e rezultateve të arritura deri më tani. Drafti i raportit të monitorimit për periudhën janar - qershor 2025 është shpërndarë për konsultim, komente dhe plotësim tek institucionet zbatuese të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, nëpërmjet pikave të kontaktit antikorrupsion në çdo institucion. Deri aktualisht rezulton një nivel zbatimi prej 72.2% e strategjisë, duke garantuar një nivel të qendrueshëm zbatimi. Politika parandaluese dhe ndërgjegjësuere kanë të dhënat më të mira prej 75% të zbatimit duke u ndjekur nga ajo ndëshkuese, me 66.6%. Në vijim, me marrjen e informacionit të përditësuar për masat dhe aktivitetet e planit të veprimit, do të bëhet një rivlerësim i progresit të arritur, duke identifikuar njëkohësisht fushat ku kërkohet më shumë angazhim dhe përmirësim. Raporti i monitorimit pritet të diskutohet dhe miratohet në takimin e Ekipit Tematik Antikorrupsion në muajin shtator.



RAPORTI I MONITORIMIT  
PËR PERIUDHËN JANAR-QËRSHOR 2025

STRATEGJIA NDRËSEKTORIALE  
KUNDËR KORRUPSIONIT  
2024 - 2030



Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit kontribuon në hartimin e instrumenteve rajonale antikorrupsion



**1-29.08.2025:** Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit vijon të forcojë bashkëpunimin rajonal përmes angazhimit aktiv në kuadër të projekteve dhe iniciativave për zhvillim të organizatës Iniciativa Rajonale Antikorrupsion - RAI. Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit është përfshirë në konsolidimin e dy dokumenteve metodologjike mbi proceset e Parandalimit të Korrupsionit në Legjislacion (CPL) dhe për Vlerësimin e Hapësirave për Korrupsion (CRA), të cilat po finalizohen për sektorin e mjedisit dhe të sigurisë e mbrojtjes. Përmes hartimit të dy metodologjive sektoriale do të mundësohet vlerësimi i riskut të korrupsionit në fazën e përgatitjes së akteve ligjore të fushës dhe të qasjes së politikave për ndërhyrje, po aq përgjatë vlerësimit të zbatimit të tyre. Metodologjia (CPL) për identifikimin e boshllëqeve ligjore që mund të krijojnë hapësira për abuzim, dhe metodologjia (CRA) për evidentimin e praktikave më të rrezikuara në prokurime, menaxhimin e burimeve njerëzore, dhënien e lejeve dhe kontrollin institucional, do tu vijë në ndihmë stafeve teknike të institucioneve gjatë detyrave funksionale. Zbatimi i këtyre instrumenteve rrit transparencën dhe llogaridhënien, duke forcuar integritetin institucional, sigurinë publike dhe mbrojtjen e biodiversitetit. Ky bashkëpunim me organizatën RAI përfaqëson një hap të rëndësishëm në përmbushjen e prioriteteve të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe në avancimin e Shqipërisë në rrugën e integritetit evropian.

Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit harton manualin e parë të veprimit për Pikat e Kontaktit Antikorrupsion

**1-15.08.2025:** Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit po harton një dokument të ri (manual) procedurash për zbatimin, monitorimin dhe raportimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe Planit të saj të Veprimit. Manuali do të jetë një document praktik, operacional pune që do të përcaktojë qartë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve udhëheqëse dhe atyre mbështetëse në zbatimin e strategjisë. Manuali do të jetë dokumenti i parë, udhëzues i shkruar mbi rolin e Pikave të Kontaktit Antikorrupsion, në nivel institucional. Dokumenti vendos theks të veçantë të bashkëpunimit ndër-institucional dhe mbështetjes që ofrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në rolin e sekretariatit teknik pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit. Manuali do të lehtësojë procesin e zbatimit të strategjisë, monitorimin dhe vetë-vlerësimin e zbatimit të saj nga institucionet, përfshirë ato të pavarura, kushtetuese të përmendura në strategji dhe me masa për zbatim. Përmes hartimit të këtij dokumenti, i cili po lehtësohet me mbështetjen e drejtpërdrejtë të ekspertizës teknike të EU4GG, synohet që mekanizmat e raportimit dhe monitorimit të integrohen si në nivel qendror, ashtu edhe në atë vendor, duke garantuar transparencë, llogaridhënie dhe përmirësim të vazhdueshëm të politikave antikorrupsion. Këto zhvillime përfaqësojnë një hap të rëndësishëm drejt forcimit të integritetit institucional dhe përmbushjes së një prej detyrimeve për rritjen dhe forcimin e kapaciteteve institucionale antikorrupsion.



Aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në fushën e hetimit dhe verifikimit administrativ përgjatë gusht 2025

**1-31.08.2025:** Gjatë muajit gusht 2025, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka konkluduar me 9 raporte përfundimtare për Drejtoritë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës. Nëpërmjet raporteve të sipërcituara, mbi bazën e analizës së plotë të fakteve dhe dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, si dhe duke marrë në konsideratë natyrën e shkeljes së konstatuar, ndikimin që ajo ka sjellë në mirëfunksionimin e institucionit përkatës, si dhe shkallën e përgjegjësisë individuale të punonjësve, janë propozuar 43 masa disiplinore përfshirë titullarë, ish-titullarë dhe punonjës të institucioneve ku është kryer hetimi. Në kuadër të hetimeve administrative vlen të theksohet fakti, në rastet kur janë evidentuar elementë të veprave penale, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka vijuar me referimin e kallëzimeve pranë organeve ligjzbatuese për ndjekje të mëtejshme penale. Konkretisht, është referuar një rast në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për veprën penale të shpërdorimit të detyrës të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal për 8 punonjës si dhe zëvendës titullarin e institucionit. Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka proceduar 6 raporte me dhënie rekomandimesh ku janë propozuar 26 rekomandime, të cilat në 12 raste adresojnë çështje të natyrës administrative dhe lidhen me procedura konkrete dhe në 14 raste adresojnë çështje me natyrë organizative si në lidhje me menaxhimin e përditshëm, procedurat e brendshme të institucionit, si dhe rekomandime të cilat adresojnë çështje të natyrës së përmirësimit të bashkëpunimit institucional.

